



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 39, Datë 29.03.2024**

**MBI**

**ECURINË E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE PËR  
PERIUdhËN 2021- 2023, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E  
OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË PËR PERIUdhËN 2021 – 2023, TË PËRDITËSUAR**

Në mbështetje të neneve 10, 16, 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin të bordit të Etit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 829 prot., datë 27. 03.2024 “Mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021-2023”,

**Konstatoi se:**

- Në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4 parashikohet se Ministria përgjegjëse për energjinë: *Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë.*
- ERE me vendimin e bordit nr. 74, datë 12.03.2021, miratoi Objektivat Strategjike të ERE-s për vitet 2021-2023 dhe në vijim është miratuar Kalendari i Përditësuar i Masave të ERE-s për zbatimin e këtyre Objektivave Strategjike. Pas analizimit dhe vlerësimit të ecurisë së zbatimit të objektivave strategjike për vitet 2021-2023, çdo vit ERE ka miratuar planin e veprimit të përditësuar me qëllim arritjen e objektivave të vendosura për periudhën 2021-2023.
- Plani strategjik tre vjeçar në fokus kishte: Incentivimin e teknologjisë së lëvizjes së makinave elektrike, sensibilizimin e konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike, mbrojtjen e konsumatorëve përmes ndërjegjësisimit, përcaktimin e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim, monitorimin e furnizuesve në treg të lirë lidhur me zbatimin e rregullores, sensibilizimin e konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike, dhënien zë të konsumatorëve, mbrojtjen e klientëve në nevojë, zhvillimin e një portali për konsumatorët.

- Vlerësohet se ERE ka përmbushur detyrat e përcaktuara në objektivat strategjike të parashikuara për periudhën 2021-2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Miratimin e raportit të realizimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023.
2. Gjetjet e këtij raportimi do të jenë pjesë e Raportit Vjetor të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**